



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:217750

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05727043

C.nr.1529/21

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Genc Hasani, me bashkëpunëtore profesionale Valbona Berisha – Tahiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh. P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Leutrim Ademi, avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës - Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, kompensim i pagës së trembëdhjetë, lartësia e objektit të kërkesës 2,911.28 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 23.05.2024, jep këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh. P, ashtu që detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës - Policia e Kosovës, që në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, dhe 2020 dhe 2021, t’ia paguaj për çdo vit shumën nga 727.82 euro, apo në total, shumën prej 2,911.28 euro, me kamatë ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë datë 29.09.2021, e gjer në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETRYOHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës - Policia e Kosovës, që paditëses Xh. P, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 134.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja përmes përfaqësuesit të tij, me datë 29.09.2021, ka paraqitur padi, të cilën e ka precizuar me datën 08.12.2023, kundër të paditurës, ku si kërkesë përfundimtare ka qenë vetëm kërkesa për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, për fund vitet 2018, 2019, 2020, 2021. Ka theksuar se në bazë të udhëzimit administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018, përkatësisht nenin 29 par.2 parashihet se personelit të policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente pagën e rregullt mujore në fund të vitit. Tutje ka shtuar se që nga hyrja në fuqi e udhëzimit në fjalë e deri më tani paditësi nuk i ka gëzuar këto beneficione, edhe përkundër faktit se kanë bërë kërkesë tek e paditura me datën 12.04.2024, por që deri më tani e njëjta nuk i ka kthyer përgjigje.

Nga këto arsye ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe të detyrohet e paditura që paditësit në emër të pagës së fund vitit t'ia paguaj shumën prej nga 727.82 Euro, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 apo në total shumën prej 2,911.28euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën përfundimtare.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për taksë gjyqësore për padi shumën prej 30.00 euro, për kërkesës shumën prej 80€, për padi shumën prej 104.00 euro, si dhe për precizim shumën prej 104.00 euro.

E paditura me datë 05.04.2024, ka parashtruar përgjigje në padinë me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se e paditura nuk ka mundësi ligjore dhe financiare në kompensimin e kërkesës së palës paditese. Nga këto arsye ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, që në këtë rast rezulton se padia e paditësit është e bazuar për arsye se: Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit me nr. Reference ... dt.07.06.2021, i cili iu është bashkangjitur shkresave të lëndës.

Nga vërtetimi i punësimit të cekur më lartë gjykata konstatoi se paditësja e ka filluar punën te e paditura nga data 01.08.2005, dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 727.82 €.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018, dhe mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për kërkesën e aprovuar të paditësit, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*.

Nga interpretimi i dispozitës të lart cituar të Udhëzimit Administrative 02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të nxjerr nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar sepse paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitoj si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësi, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performances së punës, nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi, ka vlerësim të kënaqshëm, të performancës dhe të njëjtit nuk iu është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, për gjatë viteve 2018, 2019, dhe 2020, 2021. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësit.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021, gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit, të vlerësuar si më lart, nga e cila rezulton paga të cilën e realizon paditësi punon tek e paditura qe nga date e cekur si me larte , andaj të njëjtit për vitet 2018, 2019, 2020, 2021, i takon shuma ashtu siç është vendosur në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara, që t'ia kompensoj paditësit, pagat e 13-ta, për fund vitet 2018, 2019, 2020. Andaj, paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar ne nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura ju ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj shumën e gjykuara, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 10.11.2021, dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. Gjykata ne shkresat e lendes posedon kërkesën e dorëzuar nga përfaqësuesi i paditësit për kompensim pranë te paditurës, ku e paditura i ka refuzuar te njëjtën, e qe nga ai moment i njëjti ka paraqitur padi pranë kësaj gjykate. Andaj, lidhur me kërkesën ne fjale gjykata vlerëson se padia është e rregullt dhe e paraqitur brenda afateve ligjore.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzime e procedurës, gjykata e ka bazuar në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet në shumë prej 134.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumë prej 104.00 € dhe në emër të taksës për padi shumë prej 30.00 €. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet për secilën parashtresë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtresën e dorëzuar për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtresa gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1529/2021, datë 23.05.2024

Gjyqtari,
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.